Kronikë

Grabitje me armë në Valias, zbardhet dëshmia e punonjësit të argjendarisë: Më vodhën varsen e floririt 8 mln lekë të vjetra! Grabitësi e porositi online, isha me shokun polic

Zbardhen detaje të reja në lidhje me ngjarjen e një dite më parë ku në zonën e Valiasit u raportua për një grabitje me armë zjarri.

Policia e Tiranës

Sokol Dema
27 Qershor, 09:37 | **Përditësimi: 27 Qershor, 11:42**

Share

Zbardhen detaje të reja në lidhje me ngjarjen e një dite më parë ku në zonën e Valiasit u raportua për një ***grabitje me armë zjarri***. Burime nga policia bëjnë me dije se punonjësi i një argjendarie, Luis Balliu dhe agjenti i krimeve pranë Komisariatit nr.4, Egzon Mustavataj, janë grabitur nën kërcënimin e armës nga dy persona që ende nuk janë identifikuar nga policia.

Mësohet se atyre u është grabitur një varëse floriri me vlerë 8 milionë lekë. Sipas hetimeve, Balliu kishte për qëllim që të shiste varësen e shtrenjtë një personi tjetër me të cilin kishin folur në rrjetet sociale dhe takimin e kishin lënë në vendin ku i kishte thënë blerësi. Punonjësi i argjendarisë pasi ka patur një varëse të shtrenjtë ka lajmëruar shokun e tij, efektivin e policisë së Komisariatit nr. 4.

Sipas dëshmisë së tyre, pasi kanë mbërritur në vendin e kërkuar nga klienti, një automjet me ngjyrë të zezë, tip "Golf 5", me targa te huaja, ka ndaluar afër tyre. Nga mjeti kanë dalë dy persona të maskuar me kapuç dhe shall ku njëri prej tyre mbante një automatik në dorë. Dyshohet se autori madje ka qëlluar në ajër për të frikësuar dy personat.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
FOTO/ Veliaj në Davos, vlerësohet për transformimin e Tiranës: Shembull i ndryshimit me guxim dhe kreativitet

Më pas autori tjetër ka hapur derën e makinën që ndodheshin Balliu dhe Mustavataj dhe i ka marrë varësen me vlerë 8 milionë lekë të vjetra. Menjëherë më pas punonjësi i argjendarisë ka shkuar në komisariatin nr. 5 dhe ka bërë kallëzimin.

Efektivi i policisë në momentin që ka ndodhur ngjarja ka pasur me vete pistoletën e shërbimit, por që nuk e ka përdorur. Në vendngjarje është gjetur një gëzhojë që dyshohet se i përket automatikut të autorëve.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Luis Balliu | Egzon Mustavataj | grabitje | Tirane

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM
Sondazhi i ditës:
6 muaj mungesë në Kuvend për shkak të arrestit, a duhet t'i hiqet mandati Berishës?
Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Sherr me grushte te Liqeni Artificial, arrestohet 46-vjeçari, në kërkim një tjetër! Bënë për spital të riun
27 Qershor, 09:04

Pas të nxehtit përvëlues, vendi përfshihet nga reshje shiu! Në Lezhë përmbyten rrugët
27 Qershor, 08:10

Tiranë/ Grabitje me armë në Valias, një burrë pretendon se i kanë marrë para dhe sende të tjera
26 Qershor, 18:56

VIDEO/ Mbetjet shtazore i hidhnin në gropa, nën hetim 4 administratorë subjektesh në Tiranë e Berat! Kontrolle në 18 biznese
26 Qershor, 18:00

Ish-shefi IKMT-së Sarandë, Julian Prendi dënohet për korrupsion! Kërkoi 7.500 € për të mos prishur objektin në Ksamil
26 Qershor, 17:20

Dokumenti/ KOKSH s'njeh vendimet e CAS për parregullsi, Komiteti Olimpik mbledh Asamblenë e Përgjithshme
26 Qershor, 16:24

Fermerët e Rrogozhinës bllokojnë rrugën me autokombanja: Tregun e "mbyt" gruri serb, prodhimi vendas me 20 lek/kg. Të ndërhyjë Ministria e Bujqësisë!
Yrjet Saliasi
26 Qershor, 16:12

'50 mijë lekë për të tërhequr denoncimin' Gjykata e Tiranës lë në burg oficerin e krimeve Kastriot Palushi
26 Qershor, 13:49

Tiranë/ Shfrytëzonin shtetase të huaja për prostitucion, në pranga 29 vjeçari, në kërkim motra e tij (EMRAT + FOTO)
26 Qershor, 12:34

Veliaj inspekton punimet në shkollën 9-vjeçare 'Avni Rustemi': Do jetë shkolla më e re dhe më e mirë në vend, mirëpret 850 nxënës në shtator
26 Qershor, 12:30

Taksistët e Tiranës dalin në protestë, kërkojnë ulje të çmimit të karburantit dhe respektim të tarifave në shërbim
26 Qershor, 11:35

Tiranë/ Hodhi molotov në protestën e fundit para bashkisë, ndalohet 29 vjeçari (EMRI)
26 Qershor, 11:22

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButto

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje